

RAPORT
MBI
VEPRIMTARINE E DREJTORISE SE AUDITIMIT TE BRENDSTEM
NE METE, PER VITIT 2007.

I. Organizimi, perberja dhe funksionimi i strukturave te auditimit.

Drejtoria e Auditimit te Brendshem gjate vitit 2007, ka punuar per zbatimin e Programit te Qeverise, ne zbatim te Ligjit nr.9720, date 23.04.2007, "Per auditin e brendshem ne sektorin publik", VKM nr. 345, date 1.06.2004, "Per miratimin e manualit te procedurave te auditimit te brendshem, te Kodit Etik per auditet e brendshem, dhe te Kartes se Auditimit te brendshem publik", si dhe VKM nr. 806, date 6.12.2006 "Metodika e auditimit financiar".

Struktura e Drejtorise se Auditimit te Brendshem ne METE, ka funksionuar me **10 punonjes** deri ne muajin shtator, pasi me Urdherin e Kryeministrit nr. 112, date 27.07.2007, "Per miratimin e struktures se Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes", kjo strukture eshte miratuar me **8 punonjes**. Arsyeja e miratimit te struktures me dy punonjes me pak ka ardhur si rezultat i reduktimit te subjekteve te varesise, ku mbi 26 entitete me status te ndryshem, kane pesuar ndryshime jane ristrukturuar apo bashkuar, si ne rastin e 12 ndermarrjeve dhe sh.a- ve te sistemit te minierave ku nga bashkimi i tyre u krijua Sh.a "Albminiera"etj..(Bashkelidhur listimi i entiteteve te reduktuara per periudhen viti 2006- 2007) Me Urdherin e Kryeministrit nr.163, date 23.09.2007, "Per miratimin e struktures se Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes", struktura e DAB eshte miratuar pa sektor duke u suprimuar tre sektoret me klasifikimin tre inspektor me III- a, kater inspektore me III- b dhe drejtori.

Ne perberje te kesaj strukture jane vleresuar pergjithesisht audite me kualitete profesionale, experience pune dhe perkushtim ne kryerjen e detyrave nga te cilet : Mbi 50% e stafit kane dhene provimet dhe jane certifikuar si "Audit te brendshem ne sektorin publik", ndersa 30% kane plotesuar kriteret per certifikim te perkohshem si "Audit te brendshem ne sektorin publik", kane perfunduar kursin dhe jane ne pritje te dhenies se provimeve, dhe nje eshte regjistruar per te filluar kursin e trajnimit.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9720, date 23.04.2007, "Per auditin e brendshem ne sektorin publik", varesia direkte e struktures se auditimit eshte nga Ministri.

Struktura e auditimit te brendshem ne METE zhvillon politikaten e auditimeve ne sektorin publik ne perputhje me :

- ❖ Progamin e Qeverise.
- ❖ Auditimin e Zonave me nivel rrisku me te larte.
- ❖ Auditimin e objekteve me frekuence me te larte ne renditjen e zonave te auditimit.

II. Hartimi dhe realizimi i programeve te auditit.

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit 9720, date 23.04.2007, "Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik" dhe te paragrafit te dyte te pikes 8 te Seksionit II, te VKM nr 345, date 1.06.2004, " Per miratimin e manualit te procedurave te auditimit te brendshem ..." fushat kryesore te veprimtarise se auditimit te brendshem kane qene : ***kontrolltet e brendeshme, financiare dhe te drejtimit.***

Sipas Planit Vjetor te Auditimit te vitit 2007, (miratuar me shkresen nr. 8683 prot, date 25.11.2006) te miratuar nga Ministri, **jane parashikuar te kryhen per vitin 2007, gjithsej 67 auditime.**

Per periudhen raportuese, auditimet e realizuara, sipas natyres dhe permbajtjes se tyre, grupohen :

Nr	Emertimi	Programuar	Realizuar	Diferenca
1.	Auditime mbi rregullshmerine dhe ligjeshmerine.	62	53	- 9
2.	Auditime vleresuese e tematike.	5	14	+ 9
3.	Verifikime e te tjera.	-	-	-
	Totali	67	67	

Ne funksion te permbushjes se misionit te saj, objektivat kryesore te veprimtarise audituese kane gene :

- auditimi i perdorimit efektiv dhe te dobishem te fondeve publike, zhvillimin e mireadministrimit financiar si dhe auditimin e zbatimit te ligjeshmerise ne fushen ekonomike dhe financiare.
- parashikimin e deshtimeve dhe rreziqeve ne sistemin e kontrollit te brendshem , ne procesin e vleresimit te riskut.
- zbatimi i procedurave per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne shoqerite me kapital te perbashket.
- mbikqyrja e veprimtarise se njesive te auditimit ne strukturat vartese.
- dhenia e rekomandimeve dhe te kerkesave per marrjen e masave per permiresimin e veprimtarise.

Nga perlllogaritjet e ngarkeses per cdo auditim, referuar edhe normave te auditimit te percaktuara sipas standarteve te IIA jane rezultuar mesatarisht **per rreth 7 objekte te audituar per person**

Nga totali i auditimeve te realizuara (67), **vetem 53 auditime ose 79 % e tyre kane gene te programuara ne planin vjetor 2007. Arsyeya e ketij fakti lidhet me :**

- **Angazhimin, ndjekjen dhe zbatimin e tematikave te iniciuara nga Titullari per verifikimin e problematikave, kerkesave ,apo ceshtjeve per te cilat kerkohej auditim .**

Jane realizuar 14 auditime te iniciuara nga Titullari,nga te cilat 11 auditime jane te qellimit (tematike) dhe 3 auditime jane te plota.(Bashkelidhur totali i auditimeve te kryera me urdher ministri, nga te cilat dhe ato jashte programit vjetor).

entiteteve te ne subjektet e meposhteme :

- **III. Zbulimet e shkeljet ligjore dhe demet e shkaktuara.**

Gjate auditimeve jane zbuluar dhe evidentuar te meta, mangesi dhe dukuri negative me pasoja ekonomike ne dem te pasurise publike.

Me konkretisht :

- **Vlera e pergjithshme e zbulimeve nga auditimet per kete periudhe rezulton ne shumen 2.015.976 mije leke, ose 3.3 here me shume se ne vitin 2006 e cila eshte(Vlera totale e zbulimeve = 617.866 mije leke)**

Te ndara sipas rubrikave, keto zbulime paraqiten :

A. Evazion fiskal , ne shumen 47.390 mije leke.

B. Mungesa e demtime, ne shumen 1.479.888 mije leke, kerkuar dhe ngarkuar e gjitha per zhdemtim.

C. Shkelje te disiplines financiare me dem ekonomik, ne shumen **488.698 mije leke,** kerkuar dhe ngarkuar e gjitha per zhdemtim.

D. Shkelje te disiplines financiare pa dem ekonomik :

- **Te disiplines financiare, ne 133 raste ne vleren 10.904 mije leke.**

- **Te procedurave ligjore, ne 663 raste, ne vleren 96.409 mije leke.**

Per te gjitha te metat, mangesite dhe shkeljet e disiplines financiare te konstatuara, auditet kane nderhyre dhe rekomanduar masa organizative per permiresimin e gjendjes.

Masat rekomanduese lidhen kryesisht me percaktimin e rrugeve dhe drejtimeve qe mundesojne mbylljen e shtigjeve per veprime te kunderligjshme dhe abuzive per fondet publike. Keto masa jane kryesisht te karakterit ligjor, organizativ dhe kur ka vend edhe disiplinor, te zhdemtimit, administrativ.

IV. Masa disiplinore dhe administrative per shkeljet dhe demet e shkaktuara.

Per vitin 2007, **jane dhene gjithsej 505 rekomandime dhe propozime,** te ndara si vijon :

- per permiresimin e sistemeve te organizimit te kontrollit te brendshem, **jane dhene 286 rekomandime.**
- **per 73 persona,jane rekomanduar masa disiplinore, nga te cilet 8 drejtues entitetesh.**
- **per 20 persona, jane rekomanduar gjoba ne shumen 385 mije leke.**
- **ne 122 raste, jane rekomanduar masa zhdemtimi ne shumen 163.180 mije leke.**
- **ne 4 raste, per 34 persona,**per shkelje te neneve 248,186 dhe 258 te “ Kodit Penal te Republikes se Shiperise “ jane bere denoncimet per ndjekje penale.

Nga organi qendror (METE), jane bere 4 denoncime prane Prokurorise Gjyqsore te rretheve Elbasan, Durres, Korce dhe Vlore, lidhur me ecurine e procedimit te denoncimeve te bera :

- mbi shkeljet e konstatuara prane ZSHE Durres.
- mbi shkeljet e konstatuara prane ZSHE Elbasan.
- mbi shkeljet e konstatuara prane Sh.a Trajtimi i Studenteve Vlore.
- mbi shkeljet e konstatuara prane Sh.a Kepuca Korce.

Per vitin 2007, gjate veprimtarise se DAB, vecojme keto aspekte :

1. Eshte aplikuar dhe vene ne zbatim VKM nr 806, date 6.12.2006 “ Per miratimin e metodologjise se auditimit financiar “ duke sjelle nje risi dhe nje sherbim me cilesor te veprimtarise audituese financiare, lidhur kjo me fazen pregatitore per pergatitjen e programit per auditimin e nje subjekti.

2. Ne zbatim te Urdherit te Kryeministrit nr 281, date 15.12.2006 “ Per vleresimin e perdorimit te fondeve publike per investime dhe pagesat per ndihme ekonomike, perkrahje sociale dhe sherbime shoqerore ne sektorin publik “ DAB , bazuar ne programet e auditimit te miratuara nga Drejtori i Pergjithshem i Auditimit te Brendshem ne Ministrine e Financave (i cili ka mbikqyrur dhe monitoruar zbatimin e ketij urdheri

)ka realizuar 4 auditime tematike prane ketyre entiteteve : Sh.a Armo Fier, Sh.a Albpetrol Fier, ZSHE Durres dhe TEC Fier.

3. Krahas zbulimeve dhe masave te rekomanduara , rendesi e vecante i eshte kushtuar ndjekjes dhe zbatimit te masave te rekomanduara si nje element i rendesishem ne vleresimin e efektivitetit te veprimtarise audituese.

Bazuar ne Kalendarin Vjetor te vitit 2007, dhe ne zbatim te Urdherit nr 70, date 18.04.2006 te Kryeministrit “ Per masat ne zbatim te rekomandimeve te Kontrollit te Larte te Shtetit, Auditit te Brendshem dhe Departamentit te Kontrollit te Brendshem Administrativ dhe Antikorrupsion, ne Keshillin e Ministrave, ne Institucionet ne Varesi te Kryeministrit a te Ministrave “, eshte kryer auditimi tematik me drejtim : « Verifikim i zbatimit te rekomandimeve, detyrave dhe masave ne zbatim te Urdherit te Kryeministrit nr 70, date 18.04.2006. « **Nga auditimi i kryer prane 24 entiteteve publike**, per verifikimin e zbatimit te rekomandimeve te lena, rezultoi :

a. 17 entitete publike kane hartuar , miratuar dhe derguar prane D.A.B ne METE, “Planin e veprimit per zbatimin e rekomandimeve te lena “, ndersa 7 prej tyre nuk zbatuar detyrimin e mesiper.

b. Gjithsej nga 259 rekomandime te miratuara, jane realizuar apo jane ne proces 233 prej tyre. Niveli i realizimit te tyre eshte ne masen 90 %. Pak subjekte rezultojne ne nivelin e ulet te realizimit te rekomandimeve.

4. Jane realizuar ne 2 raste, auditime te perbashketa me Ministrine e Shendetesise dhe MASH, respektivisht ne subjektet : Sh.a Fufarma Tirane dhe Sh.a Trajtimi i Studenteve Vlore.

Ne kryerjen e auditimeve jane angazhuar dhe kane qene pjese e grupit te punes jo vetem auditet e strukturave vartese por dhe specialiste te fushave perkatese, respektivisht per auditimet e kryera prane :

- Deges se Shperndarjes se Karburantit Fier.
- Drejtorise se Metrologjise dhe Kalibrimit Tirane.
- TEC Fier.
- sh.a Miniera e Boksideve Tirane.
- sh.a Kripa Vlore.
- Drejtoria e Policise Elektrike

5. Vlen te permendim se ne cdo praktike te auditimit eshte bere identifikimi dhe vleresimi i rrishtit i cili ka ndikuar ne arritjen e objektiveve te entitetit. Referuar vleres totale te zbulimeve, shprehim se fusha me me risk te larte eshte ajo ne perdorimin e fondeve publike. Zbulimet ne kete fushe zene gati 20 % ndaj totalit te zbulimeve.

6. Pervec angazhimit ne realizimin e planit vjetor, auditet kane marre pjese dhe kane deponuar ne te gjitha rastet prane Prokurorise se Rretheve Gjyqsore per te gjitha procedimet penale te filluara pas kallzimeve penale te derguara nga METE.

Pervec sa siper, nga monitorimi dhe mbikqyrja e materialeve te auditimit verehet se ne disa praktika, Raporti Final i Auditimit paraqitet me te njejtin permbajtje si Projekt

Raporti, ne kushtet kur referuar “Manualit te procedurave te auditimit”, **Raporti Final duhet te jete me konciz**, ku krahas arritjeve te veprimtarise se subjektit te audituar te perfshihen dhe evidentimet, konstatimet e zbulimet e auditimit.

Mardheniet e bashkepunimit me institucionet.

Ne veprimtarine e saj Drejtoria e Auditimit te Brendshem ka mbajtur maredhenie korrekte institucionale te qendrushme dhe te vazhdueshme me :

- Drejtorine e Pergjitheshme te Auditimit te Brendshem ne M.F.
- Drejtorite homologe prane Institucioneve qendrore.
- Prokurorite Gjyqsore neper rrethe, per te vene perpara forces se ligjit shperdoruesit e fondeve publike.
- Drejtorite brenda Aparatit te METE, per nje kordimin dhe nje qendrim sa me te plote dhe real ne konkluzionet e auditimit. E konkretisht :
- Me Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimeve Tregtare
- Me Drejtorine e Pergjithshme Rregullatore
- Me Drejtorine e Sherbimeve te Brendshme
- Me Drejtorine Juridike .

Lidhje te vazhdueshme kemi patur me KLSH , me domosdoshmerine dhe *synimin per te :*

- o Zvogeluar ne maksimumin e mundshem mbivendosjen e auditimit apo shmangur dublimet e panevojeshme.
- o Ndjekur rekomandimet e tyre.
- o Sigurimin dhe koordinimin e te gjitha perpjekjeve ne kuader te zbatimit te planit te auditimit.

Bashkelidhur ketij raporti do te gjeni Data Basen, mbi te dhenat e veprimtarise se DAB, per vitin 2007, si dhe te dhenat analitike per zbulimet dhe rekomandimet e dhena per cdo auditim.

D R E J T O R

Festime TREBICKA

